



Pranuar / Dorezuar Punëjeto / Prodato Received / Delivery	04 - 10	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	5883/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.732/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti- kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari -anëtar, me Ilire Mehmeti Shaqiri -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.732/2022 të datës 24.08.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit KA.Nr.25/2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 28.07.2022, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 04.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.732/2022 e datës 24.08.2022 e parashtruar nga ankuesi ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim dhe ri-vendosje* të Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

II. **OBLIGOHET** Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që të ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Këshillin Prokurorial të Kosovës me datën 24.08.2022, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4938/2022 të datës 24.08.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimorë që të bëhet ndryshimi i Vendimit me numër KA.Nn.25/2022 të datës 28.07.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, pasi që nuk i është njohur edhe kompensimi në mënyrë retroaktive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 05.09.2022 ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 5147/2022 për përgjigje në ankesë në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 12.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 5313/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4938/2022 të datës 24.08.2022; Vendimin me numër 1262/2022 të datës 28.07.2022; Emalin e datës 15.07.2022 të drejtuar Emalin e datës 05.07.2022 të lërtuar Emalin e datës 04.07.2022 të drejtuar Ankesën e datës 04.07.2022; Përgjigjen në kërkesë me numër të protokollit 823/2022 të datës 19.05.2022; Kërkesën për kompensimin e kujdestarisë të datës 20.12.2021; Kërkesën me numër A.nr.239/2021 të datës 21.12.2021; Vendimin me numër të protokollit.DPSKPK-15/2020 të datës 169.01.2020; Vendimin me numër Prot.DSKPK-14/2019 të datës 28.01.2019; Vendimin për lejimin e përdorimit të automjetit zyrtar me numër 16/2017 të datës 11.01.2017; Vendimin për lejimin e përdorimit të automjetit zyrtar me numër 795/2016 të datës 04.07.2016; Vendimin për lejimin e automjetit zyrtar me numër 336/2016 të datës 16.03.2016; Vendimin për lejimin e përdorimit të automjetit të zyrtarit me numër 104/2016 të datës 01.02.2016; Vendimin me numër 119/2011 të datës 21.07.2011; Vendimin me numer144/2011 të datës 10.11.2011; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5147/2022 të datës 05.06.2022; Përgjigjenin në ankesë me numër të protokollit 5313/2022 të datës 12.09.2022; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit me numër DBNJ/DSPK/134/2019 të datës 24.01.2019; Vendimin me Nr.119/2011 të datës 21.07.2011; Vendimin me Nr.144/2011 të datës 10.11.2011.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e administruara të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga administrimi i provave të lëndës, ka gjetur se ankuesi sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt emërimit me numër DBNJ/DSPK/134/2019 të datës 24.01.2019 mbanë pozitën e punës "Zyrtar i Transportit" në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa me datë 20.12.2021 Administratori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në emër të ankuesit dhe për interes të tij, ka parashtruar kërkesën me Referencë PSRK/A.Nr.239/2021 për kompensimin e kujdestarisë për zyrtarin duke u bazuar në Vendimin e Kryetarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me numër reference A.nr.119/2011 të datës 21.07.2011 për kompensimin e vozitësve në emër të kujdestarisë mujore në vlerën fikse prej njëqind euro (100€).

Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datën 18.05.2022 i është përgjigjur kërkesës së datës 20.12.2021 me arsyetimin se prej momentit të transferimit nga pozita e "Referentit" në Prokurorin Themelore në Prishtinë në pozitën "Zyrtar i Transportit" në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nuk ka qenë vozitës, pra ka qenë dhe është në pozitën "Zyrtar për Transport" me koeficient 7, dhe se shtesat për kujdestari në vlerë prej njëqind euro (100€) janë paguar dhe paguhen vetëm për zyrtarët në

pozitat "voztës" që sipas Vendimit me Nr.prot.DPSKPK/243/2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial Kosovës i datës 03.07.2019 janë shndërruar në pozitën e punës "Zyrtar për Transport 3" dhe që kanë koeficientin 5.5.

Ankuesi, i pa kënaqur me përgjigjen me numër reference DPSKPK/Nr.203/2022 të datës 18.05.2022 ka parashtruar ankesë tek Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial. Ndërsa ky i fundit me vendimin me numër KA.Nr.25/202 të datës 28.07.2022 ka marr vendim me të cilin e ka aprovuar ankesën e ankuesit që t'i njihet e drejta e kompensimit në vlerë prej njëqind euro (100€) në baza mujore konform vendimit me numër A.nr. 119/2011 të datës 21.07.2011, ndërsa ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Këshillit Prokuroria të Kosovës ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, sepse i njëjti nuk e ka njohur edhe kompensimin e pagesës në mënyre retroaktive për kohën sa i njëjti nuk e ka realizuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për kompensimin në mënyrë retroaktive të shtesave në shumën prej njëqind euro (100€), meqenëse dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sikurse edhe dispozitat e ligjit material dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij nuk e kanë rregulluar çështjen e parashkrimit të kërkesave me karakter material, andaj Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës me rastin e shqyrtimit dhe vendosjen lidhur me ankesën e ankuesit të datës 04.07.2022 dhe aprovimit të saj sa i përket pagesës së shtesës në vlerë prej njëqind euro (100€) sipas Vendimit me Nr.119/2011 të Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 21.07.2011 ka vendosur në mënyrë meritore për çështjen konkrete, mirëpo sa i përket kompensimit në mënyrë retroaktive nuk ka arritur të vendosë edhe në lidhje me këtë çështje, ngase nuk ka marr për bazë kërkesën e ankuesit të datës 20.12.2021 në emër të të cilit e kishte bërë Administratori i Prokurorisë Speciale të Kosovës, dhe se me rastin e shqyrtimit të kësaj kërkesë duhet të marrë për bazë dispozitat e legjislacionit në fuqi që parashohin një të drejtë të tillë, andaj mbi këtë bazë ankesa e ankuesit aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa sa i përket çështjes së pagesës në mënyrë retroaktive të kësaj shtese lënda kthehet në ri-shqyrtim dhe ri-vendosje në komisionin për Zgjedhjen e kontesteve dhe të Ankesave.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankesa e ankuesit është aprovuar pjesërisht edhe për faktin se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës nuk ka trajtuar çështjen në kuptim të kompensimit në mënyrë retroaktive të shtesës në vlerë prej njëqind euro (100€), ndërsa Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës konstaton se kompensimi retroaktiv ankuesit nuk mundet t'i njihet prej kohës së nxjerrjes së Vendimit me Nr.119/2011 të Këshillit Prokurorial të Kosovës i datës 21.07.2011 gjegjësisht prej momentit kur i njëjti i ka plotësuar parakushtet e përcaktuara që të jetë përfitues nga ky vendim, ngase ankuesi nuk ka parashtruar ose të paktën nuk ka arritur të dëshmojë se ka parashtruar ndonjëherë kërkesë apo ankesë të brendshme siç përcaktohet me dispozitat e ligjit material dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përpara datës 20.12.2021 kur i njëjti e ka parashtruar kërkesën për kompensim material pranë Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe për të cilën kërkesë i njëjti ka pranuar përgjigje pas pesë (5) muajsh, gjegjësisht me datë 19.05.2022 kundër së cilës i ka vazhduar procedurat ankimore.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ka vendosur që ankesa e ankuesit të aprovohet pjesërisht për arsyet e dhëna si më lartë në këtë vendim, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e ri-shqyrtimit të ankesës së ankuesit duhet të eliminojë këto të gjetura dhe të vendosë në mënyrë meritore edhe për çështjen e shtesës në mënyrë retroaktive duke marrë për bazë legjislacionin që rregullon këtë çështje specifiku. Po ashtu, me rastin e ri-vendosjes dhe ri-shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 04.07.2022 dhe nxjerrjes së aktit të ri sipas udhëzimeve të dhëna në këtë vendim, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në mbështetje të nenit 53 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative duhet ta shfuqizoi aktin e kontestuar, respektivisht Vendimin KA.Nr.25/2022 të datës 28.07.2022.

Andaj, pas shqyrtimit shkresat e lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.732/2022, datë 04/10/2022

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

